



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E AUDITIMIT TE BRENDSHEM

184
16.07.14

Nr. 5681/6 Prot.

Tiranë, më 16.07.2014

Drejtuar: **Z. Ilir ZELA**
INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM ✓

INSPEKTORATI QËNDROR

Adresa: Rruga "Frosina Plaku", Nr. 58, Godina e Observorit, Kati 0, Tiranë

Bazuar në Akt-Marëveshjen e përbashkët nr. 6269/1 datë 28.04.2014, midis Ministrisë së Financave dhe Inspektoratit Qëndror, si dhe në ligjin nr. 9720 datë 23.04.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, bashkëlidhur po ju përcjellim përfundimet e auditimit, si dhe raportin final.

Në cilësinë e titullarit të institucionit, përfundimet e auditimit duhet të adresohen nga Inspektori i Përgjithshëm për strukturat e audituara në vartësi të tij.

Për sa më sipër, bashkëlidhur dokumentat e auditimit.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

SHKËLQIM CANI


MINISTËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Nr. Prot.

Tiranë, më2014

Drejtuar: Zj. Teuta **KUKAJ**
Drejtores
Drejtoria e mbikëqyrjes dhe "e-Inspection"
Inspektoriati Qendror

Zj. Drita **PONARI**
Specialiste e Financës
Inspektoriati Qendror

Subjekti: Dërgohen përfundimet e auditimit.

Bazuar në ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, Planin e Auditimit nr.5681/2, datë 02.05.2014 dhe Urdherin e Ministrit të Financave nr. 46, datë 18.04.2014, "Për auditimin e veprimtarisë së Inspektoriatit Qendror", ka përfunduar ciklin e auditimit si dhe është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit.
Grupi i auditimit ka raportuar se;

Referuar ligjit "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", nga Inspektoriati Qendror nuk është përgatitur manuali i përgjithshëm mbi procedurat e punës për dokumentimin dhe raportimin e veprimtarisë së inspektoriateve.

Për vitin 2012 dhe 2013, institucioni nuk është bërë identifikimin e risqeve që mund të bëhen pengesë në realizimin e objektivave, si dhe nuk është hartuar regjistrin e riskut. VKM-ja, që ka miratuar procedurat për ushtrimin e kompetencave dhe rregullat për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik të inspektimit ka dalë dy vjet pas miratimit të ligjit.

Nga Inspektoriati Qendror nuk është hartuar raporti vjetor i përgjithshëm i inspektimeve për vitin 2012. Raporti vjetor i përgjithshëm i inspektimeve për vitin 2013, nuk është i plotë.

Në zbatim të ligjit, Inspektoriati Qendror nuk ka rregulla të shkruara për procedurat e planifikimit dhe të kryerjes së kontrolleve për mbikëqyrjen e inspektimeve në inspektoriatet shtetërore.

Për periudhën objekt auditimi inspektoriati nuk ka programe vjetore të miratuara për mbikëqyrjen e inspektimeve në inspektoriate.

Në një rast, detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat, nuk janë derdhur në favor të tatimeve brenda afatit ligjor.

Buxheti i parashikuar për shpenzime operative në vitin 2014, nuk është i bazuar në nevojat reale por, është parashikuar me rezerva. Ai është 5.39 herë më i lartë se buxheti i realizuar në vitin 2013.

Në një rast në muajin Prill 2014, nuk rakordon shuma e pagesave me ekstratin e degës së thesarit për 16,954 lekë.

Nga auditimi i shpenzimeve të karburantit u konstatua se nuk është mbajtur bilanci i konsumit të karburantit.

Në kundërshtim me VKM "Për rregullat e prokurimit publik", për vitin 2012, nuk është dërguar në Agjensinë e Prokurimit Publik, regjistrin e parashikimeve dhe të realizimit të prokurimeve publike.

Në kundërshtim me VKM "Për rregullat e prokurimit publik", për vitin 2014, nuk është dërguar në Agjensinë e Prokurimit Publik brenda datës 15 shkurt, por është dërguar me shumë vonesë.

Në kundërshtim me VKM "Për rregullat e prokurimit publik", nuk është hartuar dhe dorëzuar në organin qendror që ka vënë në dispozicion fondet një informacion i hollësishëm për veprimtaritë e realizuara të prokurimit.

Bazuar në gjetjet e konstatuara, të trajtuara gjërësisht gjatë procesit të auditimit, të evidentuara në projekt raport dhe në raportin përfundimtarë të auditimit, për përmirësimin e punës në të ardhmen, në bazë të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar,

Urdhëroj

1. Përfundimin e misionit të auditimit të kryer në Drejtorinë e Shërbimeve në Ministrinë e Financave.
2. Në zbatim të nenit 11, gërma b dhe c, dhe nenit 18/4 të Ligjit 9720 datë 23.04.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, subjekti i audituar duhet të marrë masa për realizimin e Planit të veprimit dhe të njoftoi brenda 30 ditësh Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave.
3. Për ndjekjen e zbatimin të rekomandimeve të auditimit, ngarkohet Inspektoriati Qendror.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

Bashkëlidhur Urdhërit, Raporti i Auditimit dhe Plani i Veprimit

ILIR ZELA

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM

Konceptoi : Bajram Kurti Përgj Grupi
Miratoi : Tatjana Elezi Drejtore
Data : 11.07.2014

PLAN VEPRIMI
PËR REKOMANDIMET E LËNA NË RAPORTIN PËRËVINDIMTAR TË AUDITIMIT
SUBJEKTI: Inspektoriat Qendrorë

Nr.	Rekomanimi	Renditja sipas nivelit.	Referenca e parag. në raport	Reagimi i menaxhimit	Afati i përcaktuar
1	Inspektoriat Qendror të hartojë dhe miratojë manualin e përgjithshëm mbi procedurat e dokumentimit dhe raportimit të veprimtarisë së inspektoriateve..	Rëndësia e lartë	Faqe 3	Pranuar	Menjherë
2	Për arritjen e objektivave, Inspektoriat Qendror të evidentojë, vlerësojë risqet dhe hartojë regjistrin e riskut.	Rëndësia e lartë	Faqe 3	Pranuar	Menjherë
3	Inspektoriat Qendrorë, menjëherë të hartojë dhe të miratojë metodologjinë mbi procedurat e planifikimit dhe kryerjes së kontrolleve për mbikëqyrjen e inspektimeve në inspektoriatet shtetërore.	Rëndësia e lartë	Faqe 5	Pranuar	Menjherë
4	Inspektoriat Qendrorë, të rakordojë me DRT Tiranë dhe në rast penalizimi, të analizojë përgjegjësitë e dëmit të shkaktuar nga mospagesa në afat e detyrimeve.	Rëndësia e lartë	Faqe 9	Pranuar	Menjherë
5	Inspektoriat Qendrorë, të analizojë nevojat për buxhet në zërin shpenzime operative për periudhën deri në fund të vitit dhe në rast se fondet rezultojnë më të larta se nevojat të kërkojë rishtëmdarje të buxhetit.	Rëndësia e lartë	Faqe 10	Pranuar	Menjherë

6	Të rakordohet urdhrë-shtpenzimet e muajit Prillë 2014 me degën e thesarit dhe të sistemohet diferenca për 16,954 lekë.	Rëndësia e mesme	Faqe 10	Pranuar	Menjherë
7	Menjherë titullari i instrukcionit të miratojë rregulla mbi mënyrën e dokumentimit dhe kontrollit të harxhimit të karburantit.	Rëndësia e lartë	Faqe 11	Pranuar	Menjherë

Për grupin e auditimit

Bajram KURTI



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Objekti i auditimit: *Auditim i Sistemit , Pajtuëshmërisë dhe Financiar.*

Njësia e audituar: *Inspektoriati Qendror.*

Njësia audituese: *Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e MF-së*

I. Hyrje

Në këtë Raport janë paraqitur gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të auditimit të kryer pas përfundimit të misionit auditues të kryer në Inspektoriatin Qendror. Fushat e auditimit sipas parashikimit në Planin e auditimit janë; vlerësimi i sistemit të Kontrollit të Brendshëm; veprimtarisë së Inspektoriatit Qendror dhe menaxhimit financiar. Auditimi u pëqëndrua në zbatimin e ligjëshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit ekonomik e financiar të periudhës 01.01.2012 deri 30.04.2014.

Inspektoriati Qendror, është institucion i pavaruar dhe nuk ka njësi auditimi në strukturën e tij. Bazuar në ligjin nr. 9720 datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, ky institucion ka nënshkruar Akt-Marrëveshje nr. 6269/1, datë 28.04.2014, me Ministrinë e Financave për mbulimin me auditim nga njësia audituese e kësaj të fundit.

II. Termat e Auditimit

Auditimi, u krye në zbatim të Planit të Auditimit, nr. 7087/1, datë 13.05.2014. Periudha e audituar është 01.01.2012 deri 30.04.2014. Ky auditim u krye gjatë periudhës 19 Maj – 13 Qershor 2014, nga auditi Bajram Kurti. Me shkesë nr. 7087/2, datë 06.06.2014, është zgjatur afati deri më 13.06.2014.

Në zbatim të Manualit të AB, është njoftuar zyrtarisht subjekti nën auditim për fillimin e këtij misioni me shkresën nr. 7087, datë 09.05.2014. Nga grupi i auditimit u zhvillua takimi i fillimit me Drejtuesit e Inspektoriatit Qendror, ku u paraqitën objektivat e auditimit dhe palët ranë dakort për fillimin e punës. Në takim mori pjesë dhe Drejtuesja e Njesisë së Auditimit të Brendshëm. U zhvillua takimi përmbyllës me përfaqësuesit e Inspektoriatit Qendror, ku u diskutuan çështjet e rezultuara gjatë auditimit, si dhe rekomandimet. Raporti paraprak, i është dërguar subjektit të audituar me shkresën nr. 7087/3 datë 27.06.2014. Për raportin paraprak të auditimit, nga subjekti i audituar janë bërë vërejtje të cilat janë depozituar me shkresën nr.7087/4, datë 11.07.2014 dhe me e-mail datë 27.06.2014. Reagimi i auditit ndaj observacioneve është shprehur në çdo pikë të raportit që është observuar.

III. Metodatat e Përdorura

Grupi i auditimit ka përdorur metoda dhe teknika auditimi në vartësi të fushës së audituar. Është përdorur metoda e analizës së komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, auditimi një për një të trasaksioneve me bankë. Janë përdorur dhe teknikat e auditimit si: sondazhe, auditimi i rasteve me zgjedhje për përlllogaritjen e pagave, kontributeve, të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi dhe kahasinin me pagesën e punonjësëve, si dhe derdhja e tatimit dhe kontributeve në favor të organeve tatimore.

IV. Gjetjet e Auditimit

Pas përfundimit të punës në terren dhe pas diskutimit me subjektin e audituar, grupi i punës paraqet gjetjet e auditimit, konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse, sipas pikave të programit, sa më poshtë:

1. Vlerësimi i sistemit të Kontrollit të Brendshëm të institucionit në të gjithë komponentët e tij.

Veprimtaria e Inspektoriatit Qendrorë është e organizuar dhe funksionon bazuar në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në VKM nr. 630 datë 14.09.2011 “Për organizimin dhe Funksionimin e Inspektoriatit Qendror”, VKM nr 696 datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoriatit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi”, në rregulloren e brendëshme të Inspektoriatit Qendror miratuar me urdhër të brendshëm nr 18, datë 24.09.2012, ndryshuar me urdhërin e brendshëm nr. 9, datë 04.03.2013, si dhe në akte e rregulla të brendëshme të institucionit. Në rregulloren e brendëshme, janë përcaktuar rregullat e funksionimit të Institucionit, detyrat dhe përgjegjësitë për drejtoritë, sektorët dhe të gjithë specialistët e këtij institucioni.

Në nene të veçanta të rregullores janë përcaktuar rregulla mbi mënyrën dhe format e komunikimit, rregullat e bashkëpunimit, raportimit, Etikës për punonjësit e Inspektoriatit Qendror dhe rregulla të tjera që lidhen me marrëdhëniet e punës.

Me urdhër të Kryeministrit nr. 83, datë 30.09.2011 është miratuar struktura dhe organika e Inspektoriatit Qendror me 12 punonjës gjithësej. Në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave në rregulloren e brendëshme.

Sipas këtij urdhëri institucioni nuk ka patur në organikë punonjës që të mbulojë problemet e financës dhe të buxhetit por, me memorandum bashkëpunimi datë 27.09.2011, ndërmjet Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), protokoll nr. 740/1 dhe Inspektoriatit Qendror, protokoll nr. 05, është rënë dakort që shërbimet mbështetëse të Inspektoriatit Qendror të kryhen nga AKSHI. Memorandumi është lidhur me autorizim nr. 2827 datë 26.09.2011 të Sekretarit të Përgjithshëm në Kryeministri.

Me urdhër të Kryeministrit nr. 5, datë 31.01.2013, është miratuar struktura dhe organika e Inspektoriatit Qendror për vitin 2013 me 15 veta. Në këtë strukturë, është shtuar në organikë një specialist finance dhe dy specialistë në sektorin e mbikëqyrjes. Për të mos krijuar konflikt ndërmjet funksioneve, disa specialistëve të drejtorive të institucionit krahas detyrës funksionale u janë ngarkuar dhe detyra të tjera si arkëtar, magazinjer, shofer etj. Këto funksione janë parashikuar në detyrat e Drejtorive në rregulloren e brendëshme. Çdo specialisti që krahas detyrës funksionale me urdhër të brendshëm të Inspektorit të Përgjithshëm është ngarkuar dhe me funksione të tjera, detyrat që do të kryejë janë shtuar me përshtimet e vendeve të punës.

Ndryshimet në strukturë janë shoqëruar me ndryshime në rregulloren e brendëshme të institucionit ku, pas nenit 6, është shtuar neni 6/1 që përfshin detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të financës.

Në rregulloren e brendëshme, neni 25 “Etika për nëpunësit e Inspektoriatit Qendror”, janë përcaktuar rregulla të etikës që punonjësi duhet të respektojë në përmbushjen e detyrave. Gjithashtu është përcaktuar mënyra e komunikimit duke respektuar shkallën hierarkike.

Me urdhër të brendshëm nr. 28, datë 17.04.2014, Inspektoriatit Qendror ka miratuar kodin e etikës për punonjësit e inspektorateve shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 16, “Misioni dhe funksionet e Inspektoriatit Qendror”, pika 2, “Inspektorati Qendror ka këto funksione”, në shkronjën c) përcaktohet se “Miraton rregulla të përgjithshme, bazë, për metodologjinë e vlerësimit të riskut, programimin e inspektimeve, dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit, si dhe raportimin e veprimtarisë së inspektorateve”;

në shkronjën ç), përcaktohet se “Miraton rregulla të përgjithshme për treguesit e përgjithshëm të efektivitetit dhe të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, si dhe kriteret e vlerësimit të tyre”;

Referuar këtyre pikave nga Inspektoriatit Qendror nuk është përgatitur një manual i përgjithshëm mbi procedurat e punës për dokumentimin dhe raportimin e veprimtarisë së inspektoriateve. Lidhur me këtë konstatim rekomandojmë:

Rekomandim nr. 1

Inspektoriatit Qendror të hartojë dhe miratojë manualin e përgjithshëm mbi procedurat e dokumentimit dhe raportimit të veprimtarisë së inspektoriateve. (Rëndësia e lartë)

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Për vitin 2012 dhe 2013, institucioni nuk ka bërë identifikimin e risqeve që mund të bëhen pengesë në realizimin e objektivave, si dhe nuk ka hartuar regjistrin e riskut. Për vitin 2014, ka nisur procesin e menaxhimit të riskut, është përgatitur draft rregullore e përgjithshme “Mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut” por, deri në momentin e auditimit nuk është hartuar regjistri i riskut. Lidhur me këtë konstatim rekomandojmë:

Rekomandim nr. 2

Për arritjen e objektivave, Inspektoriatit Qendror të evidentojë, vlerësojë risqet dhe hartojë regjistrin e riskut. (Rëndësia e Lartë)

Aktivitetet e kontrollit janë; rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synimin arritjen e objektivave. Inspektoriatit Qendror ka për mision përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë. Proceset kryesore të punës operacionale dhe financiare janë të shkruara në strukturën organike dhe në rregulloren e brendëshme. Në bazë të strukturës së miratuar ekziston ndarja e detyrave sipas përshkrimeve të punës.

Nëpunësi i autorizuar në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor. Transaksionet financiare janë kryer në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave dhe për çdo transaksion zbatohet rregulli i firmës së dyfishtë. Kryerja e pagesave apo urdhër-shpenzimi autorizohen pas firmës së nëpunsit zbatues dhe nëpunsit autorizues. Regjistrimet kontabile bëhen me anë të programit kompjuterik “Financa 5”.

Në inspektoriatin Qendror për realizimin e objektivave institucionale dhe për të plotësuar nevojat e domosdoshme të punonjësëve, sistemi IT-së, ofron informacionin e nevojshëm. Për arritjen e objektivave të bashkëpunimit dhe mbështetjes së veprimtarisë së inspektoriateve shetërore nga Inspektoriatit Qendror, është ngritur dhe funksionon portali unik i Inspektimit që administrohet dhe mirëmbahet nga Inspektoriatit Qendror. Të drejtat e aksesit në portal janë në përputhje me hierarkinë dhe funksionin e çdo punonjësi. Aksesin në përdorimin e portalit lejohet vetëm për përdoruesit e autorizuar sipas përcaktimit të dhënë në VKM nr. 696, datë 16.08.2013.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë, me shkrim, postë elektronike dhe në mënyrë verbale. Jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe telefonik sipas rregullave të përcaktuara në nenet 19, 32-35 të rregullores së brendëshme.

Monitorimi është tërsia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilën janë ngritur. Në Inspektoriatin Qendror, titullari informohet vazhdimisht nga drejtorët mbi aktivitetin e strukturave që ato drejtojnë me anë të informacioneve periodike. Drejtuesit nën mbikqyrjen e Inspektorit të Përgjithshëm, monitorojnë realizimin e çdo objektivi nën përgjegjësinë e gjithësejçilit dhe analizojnë shkaqet e mosrealizimit. Në Inspektoriatin Qendror nuk ka strukturë të auditimit të brendshëm pasi është institucion i vogël dhe pa struktura vartëse.

Si përfundim auditit arrin në konkluzion se sistemi i kontrollit të brendshëm është me risk të ulët

2. Auditimi i veprimtarisë së Inspektimit bazuar në rregullat ligjore në fuqi dhe rregullat e brendshme të institucionit.

Misioni dhe funksionet e Inspektoriatit Qendror janë përcaktua në nenin 16 të ligjit nr. 10 433 datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Në pikën 1 të këtij neni është përcaktuar se, Inspektorati Qendror ka për mision përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Për realizimin e këtij misioni Inspektorati Qendror kryen disa funksione si, të bashkërendimit dhe mbështetjes së veprimtarisë së inspektorateve, harmonizimin e kuadrit ligjor, përcaktimin e rregullave të përgjithëshme bazë të veprimtarisë së inspektimit, të programeve të inspektimit etj.

Në pikën 5 të këtij neni është përcaktuar se: “Procedurat e hollësishme për ushtrimin e kompetencave të Inspektoratit Qendror, sipas këtij neni, dhe rregullat për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik të inspektimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Në zbatim të kësaj pike Këshilli i Ministrave ka miratuar këto procedura me vendim nr. 696 datë 16.08.2013, dy vjet pas miratimit të ligjit.

Nga auditimi u konstatua se nuk ka gjetur zbatim pika IV “Bashkërendimi dhe mbështetja për programet e inspektimit”, e VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi””, në lidhje me hartimin e programeve vjetore të inspektimit për vitin 2014 nga Inspektoratet shtetërore dhe marrjen e mendimit të Inspektoriatit Qendror. Kjo ka ardhur dhe për mungesë të përgatitjes dhe miratimit nga Inspektoriati Qendror të rregullave të përgjithëshme bazë të veprimtarisë së inspektimit. Siç është rekomanduar më sipër hartimi dhe miratimi i rregullave të përgjithëshme bazë të veprimtarisë së inspektimit mbetet një detyrë parësore.

Në zbatim të ligjit nr. 10 433 datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 16, pika 2, “Inspektoriati Qendror ka këto funksione” germa “e”, për vitin 2012, nuk është përgatitur Raporti vjetor i përgjithshëm i inspektimeve. Për vitin 2013, është përgatitur raporti vjetor dhe është paraqitur për njohje Këshillit të Ministrave. Nga auditimi u konstatua se raporti vjetor i përgjithshëm i inspektimeve për vitin 2013, nuk është i plotë pasi, jo të gjithë inspektoriatet kanë paraqitur raportet vjetore të inspektimeve duke mosrespektuar këtë detyrim ligjor.

Në zbatim të ligjit nr. 10 433 datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 16, pika 2 “Inspektoriati Qendror ka këto funksione” germa “gj”, Inspektoriati Qendror në vitin 2012, ka ngritur portalin unik “e-Inspection”, ku do të pasqyrohet veprimtaria e përditëshme e inspektorateve shtetërore dhe e inspektorëve.

Gjithashtu në zbatim të germës “h” të nenit të sipërcituar, Inspektorati Qendror ka krijuar Regjistrin elektronik kombëtar të inspektorëve shtetërorë, i cili përditësohet nga ky institucion.

Në zbatim të ligjit të sipërcituar neni 16, pika 2, germa “dh” dhe të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, pika VIII “Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për Inspektimin”, Inspektoriati Qendror

nuk ka rregulla të shkruara për procedurat e planifikimit dhe të kryerjes së kontrolleve për mbikëqyrjen e inspektimeve në inspektoriatet shtetërore. Lidhur me këtë konstatim rekomandojmë:

Rekomandim nr.3

Inspektoriati Qendrorë, menjëherë të hartojë dhe të miratojë metodologjinë mbi procedurat e planifikimit dhe kryerjes së kontrolleve për mbikëqyrjen e inspektimeve në inspektoriatet shtetërore. (Rëndësia e lartë).

Për periudhën objekt auditimi, inspektoriati nuk ka programe vjetore të miratuara, për mbikëqyrjen e inspektimeve të realizuara nga inspektoriatet. Për këtë periudhë janë realizuar gjithësej 3 misione inspektimi, prej të cilave 2 misione në vitin 2012 dhe 1 mision në vitin 2013. Për çdo mision është hartuar program kontrolli prej të cilave 2 programe me indicio.

Përkatësisht:

1. Me program kontrolli nr. 125/1, datë 25.07.2012, është kryer kontroll në Inspektoriatit Qendror Teknik, që përfshim kontrollin e dosjeve të vitit 2009, 2010, 2011 e deri më 30.05.2012, të 4 subjekteve. Kontrolli është inicuar bazuar në ankesën e një subjekti.

2. Me program kontrolli nr. 123, datë 23.07.2012, është kryer kontroll në Inspektoratin e Punës, Drejtoria Rajonale Shkodër, për mbikëqyrjen e dosjeve të inspektimit të vitit 2010, 2011 deri më 18.07.2012, për 2 subjekte. Kontrolli është inicuar me ankesë të një subjekti.

Nga auditimi i dojeve të 2 kontrolleve rezultoi se, grupi i kontrollit ka zbatuar procedurat, që nga kontrolli në terren, përgatitja e raportit paraprak, raportit final, pasqyrimi i vërtetjeve të subjektit të kontrolluar përfundimet e kontrollit dhe evadimi i plotë i dojes.

3. Në vitin 2013, me program kontrolli nr. 20, datë 18.01.2013, është kryer kontroll në Inspektoriatin Sanitar Rajonal Tiranë. Objekti i kontrollit ka qenë Veprimtaria inspektuese nga inspektorët shtetëror për periudhën Shtator - Dhjetor 2012. Nga grupi i kontrollit janë zbatuar procedurat ligjore të kontrollit.

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se për periudhën objekt auditimi numri i misioneve të inspektimit me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe të ligjeve të tyre të posaçme është mjaft i vogël. Struktura ka qenë joeficiente dhe e pa mbuluar me punë për gjithë periudhën.

3.Auditimi në fushën e mënaxhimit financiar

Në Inspektoriatin Qendror, mbajtja e kontabilitetit për periudhën objekt auditimi, është bërë në përputhje me ligjin nr. 9248, datë 10.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" ndërsa, struktura, funksionimi dhe mbyllja e llogarive vjetore është bërë në bazë të vendimit të KM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore, si dhe njësisve që varen prej tyre", ndryshuar me VKM nr.25, datë 20.01.2001 "Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr.248, datë 10.04.1998" dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14 datë 28.12.2006, i ndryshuar.

Nga auditimi i bilancit kontabël u konstatua se:

Veprimet kontabile janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ku çdo regjistrim është bërë në bazë të dokumentave justifikuese dhe janë zbatuar drejt parimet e përgjithëshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Nga verifikimi i llogarive me bilancin rezulton se për vitin 2012 dhe 2013, aktiviteti është i barabartë me pasivin dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Bilanci kontabël me tregues te reduktuar për grupet e llogarive të aktivitet paraqitet si më poshtë:
Aktivi në lekë

Grupet	Emërtimi	Viti 2012	Viti 2013
A	Aktive të Qëndrueshme	59,218,966	95,898,829
B	Aktive Qarkulluese	2,430,640	27,834,884
C	Llogari të tjera Aktive	0	0
	Totali	61,649,606	123,733,713

Sipas pasqyrave financiare vjetore për vitin 2013, në aktivin e bilancit rezulton se, më datë 31.12.2013, "Aktivet e qëndrueshme" zënë 77.5 % të totalit të aktivitet, ndërsa "Aktivet qarkulluese" zënë 22.5%.

Aktivet e qëndrueshme sipas zërave të llogarive perbëhen:

		Në lekë	
A	Aktive të Qëndrueshme	Viti 2012	Viti 2013
	Të patrupëzuara gjithësej	52,500,000	52,500,000
203	Konçensione, patenta, licenca të tjera të ngjashme	52,500,000	52,500,000
	Të trupëzuara	6,718,966	43,398,829
212	Ndërtime e konstruksione	1,237,790	12,815,556
214	Instalime tekn. Makin e paisje, vegla pune	4,702,551	698,438
215	Mjete transporti	475,000	475,000
218	Inventar ekonomik	1,497,701	40,615,777
219	Amortizimi i Aktiveve të qëndrueshme	(1,194,076)	(11,205,942)
	Shuma	59,218,966	95,898,829

Për vitin 2013, aktivet e qëndrueshme rezultojnë në vlerë 95,898,829 lekë dhe perbëhen nga: Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara, "Konçensione, patenta, licenca të tjera të ngjashme" në shumën 52,500,000 lekë, ku përfshihet vlera e portalit "e-Inspection" e ndërtuar në vitin 2012. Llogaria 212 "Ndërtime e rikonstruksione", në vlerën 12,815,556 lekë dhe në krahasim me vitin 2012, është shtuar me 11,577,766 lekë, që përfaqëson vlerën e rikonstruksionit të ambjentëve të dhëna në përdorim të Inspektoriatit Qendror.

Llogaria 215 "Mjete transporti" rezulton me 475,000 lekë pa ndryshim nga viti 2012.

Llogaria 218 "Inventar ekonomik" më 31.12.2013 rezulton me gjendje 40,615,777 lekë dhe në krahasim me vitin 2012, është shtuar me 39,118,076 lekë që perbëhet nga blerje Hardëare-ve dhe blerje mobilje e orendi zyre.

Ndërsa llogaria 219 "Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara", në fund të vitit 2013 rezulton në vlerën 11,205,942 lekë dhe në krahasim me vitin 2012 është shtuar me 10,011,866 lekë si rezultat i llogaritjes së amortizimit të vitit për mjetet kryesore.

Aktivet qarkulluese në fund të vitit 2013, rezultojnë me gjendje 27,834,884 lekë dhe sipas zërave paraqiten si më poshtë:

		Në lekë	
B	Aktive Qarkulluese	Viti 2012	Viti 2013
KI 3	Gjendje inventari	465,622	312,907
31	Materiale	438,322	312,907

32	Objekte inventari	27,300	-
K14	Kërkesa Arkëtimi nga debitorët	1,965,018	27,521,977
4342	Të tjera operacione me shtetin (debitor)	1,369,136	1,370,321
45	Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jasht sistemit	595,882	26,151,656
	Shuma	2,430,640	27,834,884

Klasa e 3, "Gjendje inventari" në fund të vitit 2013 rezulton me gjendje 312,907 lekë dhe përbëhet nga gjendja e materialeve në magazinë.

Klasa e 4, "Kërkesa Arkëtimi nga debitorët", në fund të vitit 2013 rezulton me gjendje 27,521,977 lekë dhe përbëhet nga llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin (debitor)", për shumën 1,370,321 lekë.

Llogaria 45 "Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit", në fund të vitit 2013, rezulton në shumën 26,151,656 lekë, që përfaqëson grande të huaja nga USAID-i.

Bilanci kontabël me tregues të reduktuar për grupet e llogarive të pasivit paraqitet si më poshtë:

Në lekë

Grupet	Emërtimi	Viti 2012	Viti 2013
A	Fonde të veta	59,684,588	95,848,826
B	Detyrime	1,965,018	1,733,232
C	Llogari të tjera Pasive	0	26,151,656
	Totali	61,649,606	123,733,714

Nga të dhënat e përmbledhëses të pasivit të bilancit kontabël, rezulton se, "Fondet e veta" më 31.12.2013, zënë 77.5% dhe përbën pjesën kryesore të pasivit të bilancit.

Llogari të tjera pasive në shumën 26,151,656 lekë që zë 21.1% të totalit të pasivit dhe përbehet nga llogaria 475 "Të ardhura për tu marrë" nga USAID -i.

Nga krahasimi me vitin 2012, në vitin 2013 "Fondet e veta", janë shtuar me 36,164,238 lekë.

"Detyrime" zënë 1.4% të totalit të pasivit dhe në krahasim me vitin 2012 janë pakësuar me 231,786 lekë, ato përbëhen:

Në lekë

B	Detyrime	Viti 2012	Viti 2013
K1.4	Detyrime afatshkurtër	1,965,018	1,733,232
42	Personeli dhe llogari të lidhura me to	901,366	862,757
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa	126,835	107,154
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jasht sistemit	595,882	-
435	Sigurime shoqërore	279,739	361,474
466	Kreditore për mjete në ruajtje	-	362,911
467	Kreditorë të ndryshëm	61,196	38,936

Siç shihet nuk ka detyrime të pa paguara ndaj furnitoreve. Llogaritë e personelit, detyrimeve ndaj shtetit për tatim mbi të ardhurat nga punësimi dhe detyrimet për kontribute, përfaqësojnë detyrimet e muajit Dhjetor të cilat paguhen në majin Janar 2014.

Llogaria 466 "Kreditore për mjete në ruajtje" në shumën 362,911 lekë përfaqëson vlerën e garancive të kontratave.

Zbatimi i buxhetit dhe respektimi i limiteve buxhetore sipas zërave të shpenzimeve.

Detajimi dhe përdorimi i fondeve të buxhetit për vitin 2012 dhe 2013 sipas natyrës së shpenzimit dhe për çdo muaj paraqitet si më poshtë:

Në 000/ lekë

Shpenzime Sipas Natyrës	Buxheti i vitit 2012			Buxheti i Vitit 2013		
	Plani përfundmtar	Fakti	% Real	Plani përfundmtar	Fakti	% Real
600 Paga	13,994	13,994	100	17,296	16,475	95
601 Sigurime	2,132	2,021	95	2,681	2,417	90
602 Operative	4,383	3,606	82	3,828	3,078	80
231 Investime	65,000	59,259	91	83,152	73,126	88
Totali	85,509	78,880	92	106,957	95,096	89

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se në total buxheti për vitin 2012 është përdorur në masën 92% dhe për vitin 2013 në masën 89%. Realizimi i buxhetit për këtë vit është në nivel të kënaqshëm. Në mënyrë analitike sipas zërave të buxhetit problemet e konstatuara në përdorimin e tij, po i trajtojmë si më poshtë:

a). Përdorimi i fondeve për paga, shpërblime dhe të tjera personeli (llogaria 600) dhe sigurime Shoqërore (llogaria 601)

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme rezulton se, për vitin 2012 buxheti i parashikuar për paga dhe për sigurime shoqërore është përdorur në masën 100% dhe 95%. Për vitin 2013, buxheti i parashikuar është përdorur në masën 95% dhe 90%. Për 4 mujorin e vitit 2014 buxheti i parashikuar për paga dhe Sigurime Shoqërore është përdorur në masën 76.8 % . Nga 7,134 mijë lekë të parashikuara janë përdorur në fakt 5,481 mijë lekë. Mosrealizimi i buxhetit për paga në vitin 2013 dhe 4 mujorin e vitit 2014, ka ardhur nga mosplotesimi i numrit të punonjësëve të miratuar për disa muaj të vitit. Për vitin 2012, është paguar shpërblim në fund të vitit për punonjësit në shumën 99 mijë lekë, ndërsa për, vitin 2013 nuk ka pagesa për shpërblim të punonjësëve.

Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave rezultoi se për periudhën objekt auditimi, institucioni ka respektuar strukturën dhe numrin e punonjësëve sipas organikës së miratuar me urdhër të kryeministrit nr. 83, datë 30.09.2011 dhe nr. 5, datë 31.01.2013 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoriatit Qendror". Në bazë të vendimeve të mësipërme numri i punonjësëve për vitin 2012 ka qenë 12 veta dhe për vitin 2013 e në vazhdim është 15 veta.

Nga auditimi u konstatua se të gjithë punonjësit janë pjesë e strukturës së institucionit dhe se është respektuar struktura dhe nivelet e pagave sipas klasifikimit të funksioneve për punonjësit e institucionit, duke përfshirë pagën bazë mujore dhe shtesat mbi pagat.

Nga auditimi me zgjedhje, për pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore, tatimin mbi të ardhurat personale etj., rezultoi se për vitin 2012 dhe 2013, ato janë llogaritur drejt në bazë të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

Për muajin Janar 2014, u konstatua se llogaritja e detyrimeve për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat është bërë drejt dhe janë deklaruar me formularin e deklarimit elektronik më 18.02.2014. Për shkak të mungesës së firmës së nëpunsit autorizues, shkaktuar nga vakumi i krijuar me lirim nga detyra me urdhër të Kryeministrit nr

41, datë 5.02.2014, të Inspektorese së Përgjithëshme znj. Mimoza Hajdarmataj dhe emërimit të inspektorit të Përgjithshëm me urdhër të Kryeministrit nr. 102, datë 21.02.2012, derdhja e kontributeve dhe Tatimit nga të ardhurat personale në favor të tatimeve është bërë me vonesë me datë 20.03.2014.

Bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 114 “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, pika 1 dhe 2, Inspektoriati Qendror detyrohet të paguaj gjobë. Nga specialistja e financës me e-mail të datës 17.02.2014, ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm në Kryeministri për pengesën e krijuar lidhur me pagesën në afat të detyrimeve për kontribute dhe tatim nga të ardhurat personale.

Lidhur me konstatimin, Rekomandojmë:

Rekomandim nr.4

Inspektoriati Qendrorë, të rakordojë me DRT Tiranë dhe në rast penalizimi, të analizojë përgjegjësitë e dëmit të shkaktuar nga mospagesa në afat e detyrimeve. (Rëndësia e lartë).

b). Përdorimi i fondeve për mallra e shërbime (Ilogaria 602).

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme rezulton se, për vitim 2012 buxheti i parashikuar për shpenzime operative është përdorur në masën 82%, nga 4,383 mijë lekë të parashikuara janë shpenzuar 3,606 mijë lekë. Buxheti i parashikuar për shpenzime operative në vitin 2013, krahasuar me parashikimin dhe realizimin e vitit 2012, rezulton të jetë në masën 87.3% e parashikimit dhe 106.2%, e buxhetit të realizuar për këtë vit. Për vitin 2013 buxheti i parashikuar është realizuar në masën 80%, nga 3,828 mijë lekë të parashikuara janë përdorur 3,078 mijë lekë. Përdorimi i buxhetit për shpenzime operative është 528 mijë lekë ose 85.4% më pak se fakti i vitit 2012.

Për vitin 2014, buxheti i parashikuar për shpenzime operative është 16,600 lekë, 4.3 herë më i lartë se buxheti i planifikuar i vitit 2013 dhe 5.39 herë më i lartë se buxheti i realizuar për këtë vit (fakti 2013 është 3,078 mijë lekë). Sipas regjistrit të parashikimeve në mënyrë analitike janë radhitur zërat e shpenzimeve si kancelari, bojë për fotokopje, printera e faks, Shërbim pastrimi, karburant, pjesë këmbimi për makinë, siguracione dhe kolaudim makine, Abonime në shtyp, Pagesë uji, Pagesë energji elektrike, Pagesë për telefon fiks dhe celular, udhëtime e djeta jasht vendit, udhëtime e djeta brenda vendit, kosto të trajnimit dhe seminareve, shërbim roje, të gjithë këto zëra në shumën 7,266 mijë lekë ose 1.9 herë me shumë se plani total i vitit 2013 dhe 2.4 herë më i lartë se buxheti total i realizuar për këtë vit. Krahas zërave të mësipërm rezulton se, 9,334 mijë lekë janë përfshirë në zërin të tjera pa destinacion.

Në zbatim të ligjit nr. 185/2013, “Buxheti i vitit 2014”, bazuar në limitet mujore, për 4 mujorin e këtij viti janë parashikuar shpenzime operative në masën 5,146 mijë lekë dhe në fakt janë realizuar vetëm 94 mijë lekë ose 1.8% e parashikimit.

Në VKM nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” pjesa B e strategjisë “Parandalimi i krijimit të detyrimeve të prapambetura në të ardhmen”, pika 9.2 përcakton se “Si një masë e nevojshme kontrolli, regjistri i prokurimeve të depozitohet zyrtarisht dhe elektronikisht në degën e thesarit, në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe çdo rishikim i tij gjatë vitit. Në çdo rast, shuma totale e prokurimeve të jetë e barabartë ose më e vogël se fondet e miratuara për vitin buxhetor ose për më shumë se një vit (për kontratat shumëvjeçare të investimeve)”.

Në pikën 9.4 të strategjisë përcaktohet se “Duke filluar nga janari 2014, të gjithë urdhrat e prokurimit për mallrat, shërbimet dhe investimet e nxjerra gjatë vitit, përveç blerjeve emergjente me vlerë nën 10,000 lekë, duhet: i) t’i përmbahen regjistrit të prokurimeve të dorëzuar në thesar; ii) të vulosen nga dega e thesarit të rrethit nëse ka fonde buxhetore në dispozicion të institucionit,

përpara procedimit sipas rregullave të prokurimit publik. Për mallrat, shërbimet dhe investimet, për të cilat ka nisur procesi i tenderimit përpara hyrjes në fuqi të strategjisë, do të paraqitet kontrata në degën e thesarit, për t'u kontrolluar kundrejt fondeve disponibël dhe vulosur, përpara nënshkrimit të saj nga nëpunësi autorizues i njësisë. Dega e Thesarit refuzon me shkrim një urdhër prokurimi, apo kontratën si më lart, të pambuluar me fonde publike dhe për këtë njofton Agjencinë e Prokurimit Publik, e cila e publikon në faqen e internetit. Kjo iniciativë që i shërben forcimit të disiplinës kontraktuale do të publikohet gjerësisht në komunitetin e biznesit për të siguruar që furnitorët e mallrave dhe shërbimeve të qeverisë të jenë plotësisht në dijeni të kësaj kërkesë, me qëllim që një kontratë qeveritare të konsiderohet ligjërisht e vlefshme".

Mos dorzimi në APP dhe në Degën e Thesarit deri në muajin Maj 2014 të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike është bërë pengesë dhe në realizimin e angazimeve për përdorimin e fondeve të miratuara për 4 mujorin e vitit 2014.

Nga të dhënat e mësipërme arrijmë në konkluzion se kërkesat për buxhet në zërin shpenzime operative nuk janë bazuar në nevojat reale, por janë parashikuar me rezerva. Lidhur me këtë konstatim rekomandojmë:

Rekomandim nr.5

Inspektoriati Qendrorë, të analizojë nevojat për buxhet në zërin shpenzime operative për periudhën deri në fund të vitit dhe në rast se fondet rezultojnë më të larta se nevojat të kërkojë rishpërndarje të buxhetit. (Rëndësia e lartë).

Ligjeshmëria e veprimeve me bankë:

Nga auditimi i plotë i veprimeve me bankë për periudhën objekt auditimi rezultoi se veprimet kontabile janë kryer në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

Pagesat e kryera me urdhër-shpenzimi, janë të shoqëruara me dokumenta të rregullta justifikuese. Është bërë regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt në ditar dhe në fund të çdo muaji është rakorduar shuma e pagesave të bankës me ekstratin e saj. Në muajin Prill 2014 u konstatua se nuk rakordon shuma e pagesave me ekstratin e degës së thesarit për 16,954 lekë, pagesat sipas bankës më shumë se Thesari. Argumentimi i specialistes së financës është se urdhër-shpenzimet janë hedhur gabim nga dega e thesarit. Lidhur me këtë konstatim rekomandojmë:

Rekomandim nr. 6

Të rakordohet urdhër-shpenzimet e muajit Prillë 2014 me degën e thesarit dhe të sistemohet diferenca për 16,954 lekë. (Rëndësia e mesme).

Për vitin 2013, në dy raste me procedurë blerje me vlera të vogla, janë pronotuar bilata udhëtimi me avion për jasht vendit në shumën 241 mijë lekë dhe janë paguar shpenzime udhëtim e dieta për jasht vendit në shumën 238 mijë lekë. Gjithësej djeta jasht vendit 479 mijë lekë. Udhëtim e djeta brenda vendit janë paguar gjithësej në shumën 5 mijë lekë. Për vitin 2012 nuk ka patur pagesa për shpenzime udhëtim e djeta. Nga auditimi i dokumentacionit për këto pagesa nuk u konstatuan shkelje.

Nga auditimi i shpenzimeve të kryera për mallra e shërbime rezultoi se:

Shpenzimet për shërbim telefonik fix e mobile dhe shërbim postor për vitin 2012 zënë 7.5% të shpenzimeve operative për mallra e shërbime, në vitin 2013, këto shpenzime zënë 9.3% dhe në 4 mujorin e vitit 2014 zënë 71.3% të shpenzimeve operative. Pjesën tjetër të shpenzimeve e zënë spenzimet për mallra e shërbime të realizuara me procedura "Blerje me vlera të vogla". Për vitin 2012, është lidhur kontratë për shërbim pastrimi dhe është paguar shuma 156 mijë lekë. Plotësimi i nevojave me mallra e shërbime është bërë në 22 raste me procedure "Blerje me vlera të vogla"

në shumën 3, 147 mijë lekë në vitin 2012 dhe për vitin 2013, në 6 raste me procedure “Blerje me vlera të vogëla” në shumën 2,059 mijë lekë. Për 4 mujorin e vitit 2014, është zhvilluar vetëm një procedurë shërbimi për programin Financa 5 me vlerë 10 mijë lekë.

Dokumentimi i veprimeve të magazinës.

Nga auditimi i veprimeve në magazinë për periudhën objekt auditimi rezultoi se, dokumentacioni i hyrjeve dhe daljeve të mallrave dhe materialeve është plotësuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të gjithë hyrjet në magazinë janë shoqëruar me dokumenta justifikuese. Dalja e mallrave dhe materialeve nga magazina është kryer me urdhër dorzimi. Nga auditimi në magazinë nuk rezultuan mallra stok dhe me qarkullim të ngadalshëm.

Për periudhën objekt auditimi institucioni, ka në inventar dhe në gjendje pune një automjet me vlerë 475,000 lekë. Automjeti është blerë në vitin 2012 me procedurë blerje me vlera të vogla. Me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm është caktuar një nga punonjësit e institucionit për administrimin e automjetit aktualisht Ervin Uldedaj.

Me procesverbal testimi është përcaktuar normativa e konsumit të karburantit për automjetin, 15 litra për 100/km.

Për periudhën Tetor-Dhjetor 2012, automjeti është furnizuar me 600 litra karburant me vlerë 103,380 lekë, mesatarisht 200 litra karburant në muaj. Dokumentimi konsumin të karburantit për këtë periudhë është bërë me fletë-udhëtimi.

Me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm për periudhën Tetor 2012 deri në Maj 2013, për administrimin e automjetit ka qenë ngarkuar z. Sajmir Neza. Për periudhën Qershor 2013 deri në Mars 2014, për administrimin e automjetit ka qenë ngarkuar z. Emil Balteza. Të dy këta persona aktualisht të larguar nga institucioni.

Për vitin 2013, automjeti është furnizuar me 1,760 litra naftë me vlerë 303,248 lekë, mesatarisht 147 litra në muaj. Në periudhën Janar-Prill 2013, janë tërhequr nga magazina 350 litra naftë dhe dokumentimi konsumin të karburantit është bërë me fletë-udhëtimi. Sipas fletë-udhëtimeve të muajit Maj dhe Qershor 2013, janë shpenzuar 750 litra naftë ose 42.6% e konsumit të vitit 2013. Për periudhën Janar-Prill 2014, automjeti është furnizuar me 420 litra naftë me vlerë 73,036 lekë, mesatarisht 105 litra në muaj.

Dërgimi (të skanuara) i fletë-udhëtimeve të periudhës Tetor-Dhjetor 2012, merren në konsideratë në raportin final.

Blerja e karburantit për vitin 2012 dhe 2013, është bërë me procedurë “Blerje me vlera të vogla”. Edhe për vitim 2014, është parashikuar që plotësimi i nevojave me karburant të realizohet me procedurë “Blerje me vlera të vogla”.

Nga auditimi u konstatua se nuk është mbajtur pasqyra e bilancit të konsumit të karburantit ku të evidentohen gjendja e karburantit në fillim të çdo periudhe (muaji,viti), furnizimi për periudhën sipas magazinës, konsumi sipas km të përshkuara me normativën për 100 km dhe gjendja në fund të periudhës, duke mos justifikuar me dokumenta sasinë e karburantit të tërhequr nga magazina. Mosmbajtja e bilancit të konsumit të karburantit ngarkon me përgjegjësi personat e ngarkuar me detyrën e administrimit të automjetit sipas periudhave.

Lidhur me konstatimin e mësipërm rekomandojmë:

Rekomandim nr.7

Menjëherë titullari i instucionit të miratojë rregulla mbi mënyrën e dokumentimit dhe kontrollit të harxhimit të karburantit. (Rëndësia e lartë).

Inventarizimi i pasurisë

Bazuar në nenin 6, pika 1, germa “e” të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në

njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Inventarizimi i aktiveve”, pikat 42 dhe 43 është kryer inventari i aktiveve. Me urhër të brendshëm nr. 2, datë 06.01.2014, është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve. Komisioni ka kryer inventarin dhe ka plotësuar fletët inventarit të cilat janë nënshkruar nga komisioni dhe përgjegjësi material. Fletët e inventarit të çdo punonjësi dhe gjendja në magazinë janë të kuadruara me përmbledhësen e inventarit dhe gjendjen e llogarive sipas bilancit të datës 31.12.2013. Nga komisioni nuk janë evidentuar mallra për jashtë përdorimit.

c). Përdorimi i fondeve për Investime (llogaria 231).

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme rezulton se, për vitim 2012, buxheti i parashikuar për shpenzime kapitale është përdorur në masën 91%, nga 65,000 mijë lekë të parashikuara janë përdorur 59,250 mijë lekë. Buxheti i përdurur për investime është realizuar me procedurë “Prokurimi”, në dy raste në shumën 54,791 mijë lekë dhe me procedurë “Blerje me vlera të vogla”, në 13 raste me vlerë 4,468 mijë lekë.

Për vitin 2013, buxheti i parashikuar për shpenzime kapitale është përdorur në masën 88%, nga 83,152 mijë lekë të parashikuara, prej të cilave 57,000 mijë lekë me financim nga buxheti shtetit dhe 26,152 mijë lekë financim i huaj, janë realizuar 73,126 mijë lekë prej të cilave 26,152 mijë lekë janë financuar nga USAID-i sipas marrëveshjes nr 182 datë 15.02.2013.

Përdorimi i fondeve për Investime me procedurë prokurimi.

Inspektoriati Qendror si institucion i krijuar në vitin 2011, për plotësimin e nevojave në zhvillimin e veprimtarisë së tij, është mbështetur me fonde nga buxheti i shtetit.

Për periudhën objekt auditimi Inspektoriati Qendror ka zhvilluar 7 procedura prokurimi prej të cilave 3 procedura në vitin 2012 dhe 4 procedura në vitin 2013, sipas pasqyrës së mëposhtme:

Në lekë

Procedura e zhvilluar	Nr i Procedurave Të zhvilluara	Fondi Limit I prokuruar	vlera Kontratës	Diferenca
Tender i hapur	2	133,540,613	125,425,950	8,114,663
Tendër i përqëndruar i hapur	1	2,375,767	1,909,619	466,148
Tender kërkesë për prpozim	2	9,318,523	7,157,307	2,161,216
Kërkesë për prpozim me lote	1	6,150,000	2,038,040	4,111,960
Tendër negocim pa shpallje	1	1,336,768	1,336,768	0
Shuma	7	152,721,671	137,867,684	14,853,987

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2012, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, pika 3, germa “b”, institucioni nuk ka dërguar në Agjensinë e Prokurimit Publik, regjistrin e parashikimeve dhe të realizimit të prokurimeve publike.

Per vitin 2013, sipas shkresës nr.49/1 datë 15.02.2013, është dërguar në Agjensinë e Prokurimit Publik, regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike.

Për vitin 2014, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, pika 3, germa “b”, paragrafi dytë regjistri i Parashikimit të prokurimeve publike dhe realizimit të shpenzimeve korente nuk është dërguar në Agjensinë e Prokurimit Publik brenda datës 15 shkurt, por është dërguar me shumë vonesë, me shkresën nr. 110, datë 09.05.2014.

Në zbatim të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, pika 3, germa “b”, “Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik”, paragrafi parë autoriteti kontraktor është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që parashikohet në udhëzimet e APP-së.

Nga auditimi i ushtruar mbi zbatimin e procedurave të prokurimit për tenderat e zhvilluar në Inspektoriatin Qendror për vitin 2012 dhe 2013 rezultoi se janë mbajtur rregullisht dhe në afatin kohor procesverbalet e mbledhjeve të komisionit të vlerësimit të ofertave, njoftimet e firmave pjesëmarrëse në tender si dhe relacionet për titullarin e autoritetit kontraktor. Në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", pika 3, germa "d" "Raportimi i realizimeve të prokurimit publik", brenda datës 10 Maj, 10 Shtator dhe 10 Janar të çdo viti, nuk është hartuar dhe dorëzuar në organin qendror që ka vënë në dispozicion fondet një informacion i hollësishëm për veprimtaritë e realizuara të prokurimit.

Për vitin 2012

1.Tenderi me objekt "Ndërtim i infrastrukturës së sistemit të Inspektoriatit qendror "e-Inspection" dhe kuotimi i mirëmbajtjes së sistemit për periudhën 4 vjet e aplikueshme pas përfundimit të garancisë 1 vit".

Tenderi është zhvilluar mbi bazën e Urdhër Prokurimit nr.77 datë 18.05.2012 me procedurë "Tender i hapur", me fond limit 79,120,000 lekë pa TVSH. Fondi limit është ndarë në 46,000,000 lekë për ndërtimin e infrastrukturës "e-Inspection" dhe 33,120,000 lekë për mirëmbajtjen e sistemit për 4 vjet, e aplikueshme pas përfundimit të garancisë 1 vit. Me urdhër të brendshëm nr 71/1 datë 11.05.2012, është ngritur komisioni për përcaktimin e fondit limit për tenderin "Ndërtim i infrastrukturës së sistemit të Inspektoriatit qendror "e-Inspection" dhe kuotimi i mirëmbajtjes së sistemit për periudhën 4 vjet e aplikueshme pas përfundimit të garancisë 1 vit".

Komisioni, bazuar në studimin e tregut dhe projektin zbatimin, "Ndërtimit të sistemit elektronik" hartuar nga shoqëria "Alfa Services" shpk, përzgjedhur fituese, me procedurë prokurimi "Blerje me vlera të vogla" zhvilluar në zbatim të urdhër prokurimit nr. 13, datë 23.04.2012, me shkresën nr. 75, datë 17.05.2012, ka përcaktuar fondin limit për këtë objekt prokurimi. Në zbatim të kreut V "Zhvillimi i procedurave", pika 1/a dhe 2/ç e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, para hapjes së procedurës me shkresën nr. 74 datë 14.05.2012, drejtuar Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), titullari i autoritetit kontraktor, krahas kërkesës për miratim projekti ka kërkuar dhe asistencë teknike. AKSHI me shkresën nr.477/1, datë 18.05.2012, ka njoftuar institucionin për miratimin e projektit dhe me shkresën nr. 477/2, datë 18.05.2012, ka vendosur në dispozicion të institucionit për zhvillimin e procedurave të prokurimit Znj. Jonida Osmanlliu si anëtare e njësisë së prokurimit dhe Z. Roland Kerçuku si anëtarë të KVO-së.

Me Urdhërin nr.99, datë 15.06.2012, në bazë të pikës 2/ç të VKM të sipërcituar, titullari i autoritetit kontraktor ka emëruar Komisionin e Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga Admir Malaj Kryetar, Teuta Kukaj dhe Roland Kerçuku anëtarë.

Njësia e prokurimit e përbërë nga Najada Hoxha, Xhovena Xhymerti dhe Jonida Osmanlliu, ngritur me urdhërin e prokurimit, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar dhe të pikës 1, germa "ç" e kapitullit V të VKM nr.1, me datë 23.05.2012, ka hartuar dokumentat e tenderit.

Si datë e zhvillimit të procedurës së prokurimit (Elektronike) është caktuar 18.06.2012.

Në fazën para hapjes së ofertave nuk janë paraqitur ankesa. Komisioni i vlerësimit të ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga 3 operatorë pjesëmarrës ka kualifikuar 2 operatorë dhe ka skualifikuar një operator. Skualifikimi i operatorit është bërë për mangësi në dokumentacion dhe bazuar në shkresën e APP-së nr. 7858/1 datë 22.06.2012, që ka miratuar mosmarrjen në shqyrtim të ofertës së paraqitur nga operatori me zarf, jasht rrugës elektronike.

Në përfundim të procedurave është shpallur fitues bashkimi i operatorëve IkubInfoSoft shpk & Infosoft Systems shpk, me të cilët është lidhur kontrata nr.130, datë 31.07.2012 me vlerë totale 75,250,000 lekë pa tvsh dhe 90,300,000 lekë me tvsh. Vlera e kontratës përbëhet nga vlera e ndërtimit të infrastrukturës “e-Inspection” në shumën 52,500,000 lekë me tvsh dhe vlera për mirëmbajtjen e infrastrukturës “e-Inspection” për 4 vite pas përfundimit të garancise 1 vit, në shumën 37,800,000 lekë me tvsh.

Për lidhjen e kontratës palët kanë rënë dakort që kontraktori duhet të paraqesë dy sigurime kontrate përkatësisht: Sigurimin e kontratës për ndërtimin e infrastrukturës “e-Inspection” në masën 10% të vlerës së ndërtimit në shumën 5,250,000 lekë dhe Sigurimin e kontratës për mirëmbajtjen e infrastrukturës “e-Inspection” në masën 10% të vlerës së mirëmbajtjes për 4 vite në shumën 3,780,000 lekë.

Ndërtimi i infrastrukturës “e-Inspection” është marrë në dorëzim nga komisioni i përbërë Drilona Osmanaj, Xhovena Xhymerti dhe Saimir Neza me aktin nr. 300, datë 03.12.2012.

Sipas kushteve të kontratës së nënshkruar pagesat për mirëmbajtjen e infrastrukturës “e-Inspection” fillojnë nga Janari i vitit 2014 dhe vazhdojnë për 4 vite. Bazuar në konstatimin e mësipërm rekomandojmë:

Argumentat e dhënë në observacion nr 7087/4 datë 11.07.2014 dhe kopja e formularit të sigurimit të kontratës dërguar Inspektoriatit Qendror nga IkubInfo shpk me shkresë nr. 76, datë 30.06.2014, nga grupi i auditimit merren në konsideratë. Shkelja e procedurave të trajtuara në Raportin Paraprak të auditimit bie dhe rekomandimi nr. 8 dhe 9 nuk dalin në Raportin Përfundimtar. (Fotokopja e formularit të sigurimit të kontratës dhe shkresa e IkubInfo shpk pjesë e dosjes së auditimit)

2.Tenderi me objekt “Rikonstruksion i ambjenteve të dhëna në përdorim për Inspektoriatin Qendror”

Tenderi është zhvilluar mbi bazën e Urdhër Prokurimit nr.239, datë 18.10.2012 me procedurë “Kërkesë për Propozim”, me fond limit 7,485,190 lekë pa TVSH, pas anulimit nga titullari i autoritetit kontrator me shkresën nr. 224 datë 15.10.2012, të procedurës në zbatim të Urdhër Prokurimit nr 204 datë 28.09.2012. Anullimi i procedurës është bërë pas publikimit të njoftimit dhe DST, me argumentin, rishikimi i dokumentave standarte të tenderit me qëllim respektimin e parimit të barazisë dhe transparencës. Në urdhërin e prokurimit është ngitur njësia e prokurimit e përbërë nga Najada Hoxha, Xhovena Xhymerti dhe Martin Prenoj.

Bazuar në projektzbatimin dhe preventivin e projektzbatimit për rikonstruksionin e zyrave të IQ, përgatitur nga subjekti “Person fizik” Artur Çakalli, përzgjedhur fitues, me procedurë prokurimi “Blerje me vlera të vogla”, zhvilluar në zbatim të urdhër prokurimit nr. 18, datë 15.08.2012, dhe marrë në dorëzim me Akt-Marrje nr. 200, datë 29.09.2012, është përcaktuar fondi limit për këtë objekt prokurimi.

Në zbatim të kreut V “Zhvillimi i procedurave”, pika 2/ç e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, titullari i autoritetit kontraktor, me urdhërin nr.258, datë 01.11.2012, ka emëruar Komisionin e Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga Admir Malaj Kryetar, Drilona Osmanaj, Arselma Kabashi, Teuta Kukaj dhe Saimir Neza anëtarë.

Njësia e prokurimit, ngritur me urdhërin e prokurimit, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe të pikës 1, germa “ç” e kapitullit V të VKM nr.1, me datë 22.10.2012, ka hartuar dokumentat e tenderit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit (Elektronike) është 02.11.2012.

Në fazën para hapjes së ofertave nuk janë paraqitur ankesa.

Komisioni i vlerësimit të ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht në faqen e APP-së nga 9 operatorë pjesëmarrës ka kualifikuar 4 operatorë dhe ka skualifikuar 5 operatorë. Skualifikimi i operatorëve është bërë për mangësi në dokumentacion.

Në përfundim të procedurave KVO ka hartuar raportin përmbledhës nr. 285, datë 16.11.2012 i cili është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor. Fitues është shpallur bashkimi i operatorëve "Andi-A shpk & Beladi" shpk, me të cilët është lidhur kontrata nr. 299, datë 03.12.2012 me vlerë 6,037,107 lekë pa tvsh dhe 7,244,528 lekë me tvsh.

Sipas kontratës, data e fillimit të punimeve është 03.12.2012, me afat përfundimi një muaj. Sipas procesverbalit të fillimit të punimeve datë 17.12.2012, punimet nuk kanë filluar në datën 03.12.2012 për shkak të vonesave në lirimimin e ambjentëve. Në ambjentet që do të rikonstruoheshin ka patur lëndë të rrezikshme laboratorike. Për shkak të fillimit me vonesë të punimeve me shkresën nr. 335/1, datë 31.12.2012, sipërmarrësi ka kërkuar shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve. Investitori ka miratuar kërkesën dhe palët kanë nënshkruar shtesë kontrate nr. 335/2 datë 31.12.2012, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve deri më 25.01.2013. Punimet janë mbikëqyrur nga "Supervizion Profesional" shpk përzgjedhur me procedurë blerje me vlera të vogla, me të cilën është lidhur kontrata nr.303/1 datë 07.12.2012. Punimet kanë përfunduar më 25.01.2013 dhe me datë 10.02.2013 është bërë kolaudimi i punimeve nga kolaudatori i përzgjedhur me procedurë blerje me vlera të vogla, me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit nr. 24/1, datë 25.01.2013.

Nga auditimi u arrijmë në konkluzion se procedurat e zhvillimit të tenderit janë në përputhje aktet ligjore në fushën e prokurimit publik.

Për vitin 2013

1. Tenderi me objekt "Rikonstruksion i ambjentëve të dhëna në përdorim për Inspektoriatin Qendror", Kontratë Shtesë.

Ndërtesa ku ndodhen ambjentet e dhëna në përdorim të Inspektoriatit Qendror është me dy kate. Kati 0, me VKM nr. 473, datë 25.07.2012 i është dhënë në përdorim Inspektoriatit Qendror. Ngjitja në katin e parë bëhej me shkallë të brendshme. Nga Inspektoriatit Qendror me shkresën nr. 39, datë 05.02.2013, drejtuar Rektorit të Universitetit Politeknik, dhe drejtorit të Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit është kërkuar lejimi i ndërtimit për mbylljen e shkallës nga brenda dhe spostimin e tyre në pjesën e mbrapme të ndërtesës. Janë bërë ndryshimet në project dhe pas miratimit të dhënë nga Rektoriati i Universitetit Politeknik të Tiranës me shkresën nr. 356/1, datë 28.03.2013, titullari i autoritetit kontraktor me urdhër të brendshëm nr. 108, datë 29.03.2013, ka urdhëruar kryerjen e prokurimit me negociim pa shpallje duke argumentuar arsyet e përzgjedhjes së kësaj procedure. Argumentat e dhenë janë, se ka të bëjë me zgatjen e afatit të kontratës, nevojën për punë është shkaktuar nga rrethana të paparashikuara dhe vlera e kontratës nuk i kalon 20% të vlerës së kontratës fillestare. Me subjektin bashkimi i operatorëve "Andi-A shpk & Beladi" shpk, është lidhur shtesë kontrate nr. 108/4, datë 05.04.2013 me vlerë 1,336,768 lekë me tvsh.

2. Tenderi me objekt "Rikonstruksion i ambjentëve të dhëna në përdorim për Inspektoriatin Qendror", Faza e dytë me dy lote.

Tenderi është zhvilluar mbi bazën e Urdhër Prokurimit nr.172, datë 29.05.2013 me procedurë "Kërkesë për Propozim", me fond limit 6,150,000 lekë pa TVSH për të dy lotet. Fondi limit është

i ndarë në 3,559,255 lekë për lotin e parë rikonstruksion i jashtëm i godinës dhe 2,590,745 lekë, për lotin e dytë Furnizim e vendosje të sistemit të kondicionimit.

Në urdhërin e prokurimit është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga Najada Hoxha, Xhovena Xhymerti dhe Ervin Uldedaj.

Bazuar në projektzbatimin dhe preventivin e projektzbatimit për rikonstruksionin e zyrave të IQ, përgatitur nga person fizik Artur Çakalli, përzgjedhur fitues, me procedurë prokurimi “Blerje me vlera të vogla”, zhvilluar në zbatim të urdhër prokurimit nr. 18, datë 15.08.2012, dhe marrë në dorëzim me Aktmarrje nr. 200, datë 29.09.2012, është përcaktuar fondi limit për këtë objekt prokurimi.

Në zbatim të kreut V “Zhvillimi i procedurave”, pika 2/ç e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, titullari i autoritetit kontraktor, me urdhërin nr.173, datë 29.05.2013, ka emëruar komisionin e vlerësimit të ofertave i përbërë nga Admir Malaj Kryetar, Emil Balteza dhe Aida Fejzo anëtarë.

Njësia e prokurimit ngritur me urdhërin e prokurimit, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe të pikës 1, germa “ç” e kapitullit V, të VKM nr.1, me datë 29.05.2013, ka hartuar dokumentat e tenderit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit (Elektronike) është 10.06.2013.

Në fazën para hapjes së ofertave nuk janë paraqitur ankesa.

Kanë depozituar kërkesë për pjesëmarrje në tender 6 operatorë për lotin e parë dhe 5 operatorë për lotin e dytë. Komisioni i vlerësimit të ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht në faqen e APP-së nga 6 operatorë pjesëmarrës për lotin e parë ka kualifikuar 4 operatorë dhe ka skualifikuar 2 operatorë. Për lotin e dytë janë skualifikuar ofertat e paraqitura nga të 5 operatorët. Skualifikimi i operatorëve për të dy lotet është bërë për mangësi në dokumentacion.

Në përfundim të procedurave KVO, ka hartuar raportin përmbledhës nr. 173/1, datë 24.06.2013 i cili është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor. Fitues për lotin e parë është shpallur Firma “Hysi” shpk, me të cilët është lidhur kontrata nr. 196, datë 03.07.2013 me vlerë 2,038,040 lekë pa tvsh dhe 2,445,648 lekë me tvsh. Për lotin e dytë procedura është mbyllur pa fitues.

3. Tenderi me objekt “Mobilim Zyrash”

Tenderi është zhvilluar mbi bazën e Urdhër Prokurimit nr.74, datë 04.03.2013 me procedurë “Kërkesë për Propozim”, me fond limit 1,833,333 lekë pa TVSH. Në urdhërin e prokurimit është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga Najada Hoxha, Xhovena Xhymerti dhe Ervin Uldedaj.

Në zbatim të kreut V “Zhvillimi i procedurave”, pika 2/ç e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, titullari i autoritetit kontraktor, me urdhërin nr.74/1, datë 04.03.2013 ka emëruar komisionin e vlerësimit të ofertave i përbërë nga Teuta Kukaj Kryetar, Djana Dalla dhe Ledio Braho anëtarë.

Njësia e prokurimit ngritur me urdhërin e prokurimit, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe të pikës 1, germa “ç” e kapitullit V, të VKM nr.1, me datë 05.03.2013, ka hartuar dokumentat e tenderit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit (Elektronike) është caktuar më 18.03.2013.

Në fazën para hapjes së ofertave nuk janë paraqitur ankesa.

Kanë depozituar kërkesë për pjesëmarrje 6 operatorë. Komisioni i vlerësimit të ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht në faqen e APP-së, nga 6 operatorë pjesëmarrës ka kualifikuar 1 operator dhe ka skualifikuar 5 operatorë. Skualifikimi i operatorëve është bërë për mangësi në dokumentacion.

Në përfundim të procedurave KVO, ka hartuar raportin përmbledhës nr. 110 datë 29.03.2013 i cili është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor. Fitues është shpallur Firma "Erzeni" shpk, me të cilën është lidhur kontrata nr. 141, datë 24.04.2013, me vlerë 1,120,200 lekë pa tvsh dhe 1,344,240 lekë me tvsh.

Afati i realizimit të kontratës është 15 ditë nga data e lidhjes. Mobiljet, janë marrë në dorëzim me Faturën nr. 213, datë 10.06.2013 me një muaj vonesë nga afati i përcaktuar në kontratë. Për justifikimin e shtyrjes së afatit ndërmjet palëve është nënshkruar Amendim i kontratës nr. 141/1 datë 29.05.2013, me 20 ditë pas përfundimit të afatit të kontratës bazë. Sipas amendimit të kontratës afati shtyhet deri më 11.06.2013. Në amendim nuk jepen argumenta mbi shkaqet që kanë çuar në shtyrjen e afatit të realizimit të kontratës.

4.Tenderi me objekt "Blerje Hardëare"

Në zbatim të VKM nr. 248, datë 27.04.2007 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar, pika 3, germa, "ç", Inspektoriati Qendror, me shkresën nr. 117, datë 03.04.2013, i ka kërkuar AKSH –it, miratimin e specifikimeve teknike të përgatitura për blerjen e Hardëare-ve. AKSHI me shkresë nr. 371/1 datë 04.04.2013 protokolluar në IQ me nr. 117/1 datë 04.04.2013, ka miratuar specifikimet teknike të përgatitura dhe të kërkuara nga IQ.

Tenderi është zhvilluar mbi bazën e Urdhër Prokurimit nr.122 datë 03.04.2013 me procedurë "Tender i hapur", me fond limit 54,402,663 lekë pa TVSH për dy lote. Fondi limit është i ndarë në 50,679,783 lekë për lotin e parë "Blerje Notebook" dhe 3,740,880 lekë për lidhje PC-Notebook me Internetin. Në urdhërin e prokurimit është ngitur njësia e prokurimit e përbërë nga Najada Hoxha, Sajmir Neza dhe Ervin Uldedaj.

Në zbatim të kreut V "Zhvillimi i procedurave", pika 2/ç e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, titullari i autoritetit kontraktor, me urdhërin nr.123, datë 03.04.2013 ka emëruar komisionin e vlerësimit të ofertave i përbërë nga Drilona Osmanaj Kryetar, Djana Dalla dhe Xhovena Xhymerti anëtarë.

Njësia e prokurimit e ngritur me urdhërin e prokurimit, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar dhe të pikës 1, germa "ç" e kapitullit V të VKM nr.1, me datë 04.04.2013, ka hartuar dhe miratuar dokumentat e tenderit. Titullari i autoritetit kontraktor me urdhër nr. 124, datë 04.04.2013 ka miratuar DST dhe njoftimin e kontratës. Njoftimi i kontratës i është dërguar APP-së me shkresë nr. 125, datë 04.04.2013.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit (Elektronike) është caktuar më 29.04.2013.

Njësia e prokurimit me procesverbal datë 19.04.2013, ka bërë modifikimin e dokumentave standarte të tenderit dhe është shtyrë afati i fundit për hapjen e ofertave, si datë e fundit për hapjen e ofertave është caktuar data 06.05.2013.

Me shkresën nr. 150, datë 26.04.2013, operatori "B-360" ka bërë kërkesë për ndryshime në dokumentat e tenderit.

Me shkresën nr. 151, datë 29.04.2013, operatori "Fostech" shpk ka depozituar ankesë ku ka kërkuar ndryshim të specifikimeve teknike.

Bazuar në VKM nr.1, me datë 04.04.2013 "Për rregullat e prokurimit publik", Kreu IX "Shqyrtimi i ankesave", pika 1, germa, "a/1", ankesat për dokumentat e tenderit, operatorët ekonomikë mund ti paraqesin pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, rezulton se: ankesa nr. 150, datë 26.04.2013 dhe nr. 151 datë 29.04.2013, janë bërë jasht këtij afati, me mbi 20 ditë pas afatit të publikimit të njoftimit të kontratës. Depozitimi jasht afatit të përcaktuar i bën ankesat të pavlerëshme.

Bazuar në VKM nr.1, me datë 04.04.2013 "Për rregullat e prokurimit publik", Kreu IX "Shqyrtimi i ankesave" pika 1, germa "d", me shkresë nr. 150/1 datë 03.05.2013 dhe nr. 151/1, datë 03.05.2013, autoriteti kontraktor u ka kthyer përgjigje operatorëve që kanë paraqitur ankesë duke respektuar afatin 7 ditë kalendarike nga marrja e ankesës.

Hapja e ofertave në mënyrë elektronike është bërë me datë 06.05.2013.

Kanë depozituar kërkesë për pjesëmarrje për lotin e parë 3 operatore dhe për lotin e dytë 2 operatorë. Komisioni i vlerësimit të ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht në faqen e APP-së, nga 3 operatorë pjesëmarrës për lotin e parë dhe 2 operatorë për lotin e dytë ka kualifikuar 1 operator për të dy lotet dhe ka skualifikuar 2 operatorë për lotin e parë dhe një operator për lotin e dytë. Skualifikimi i operatorëve është bërë për faktin se nuk kanë paraqitur ofertë ekonomike por vetëm dokumentacionin e pjesëmarrjes në tender.

Në përfundim të procedurave KVO, ka hartuar raportin përmbledhës nr. 123/1, datë 17.05.2013 i cili është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor. Fitues është shpallur Firma "Infosoft System" shpk, me të cilën është lidhur kontrata nr. 189, datë 20.06.2013, për lotin e dytë me vlerë 3,500,350 lekë pa tvsh dhe 4,200,420 lekë me tvsh dhe kontrata nr. 189/1, datë 20.06.2013, për lotin e parë me vlerë 46,675,600 lekë pa tvsh dhe 56,010,720 lekë me tvsh.

Dorëzimi i hardëare-ve është bërë me faturën nr. 80761709 datë 18.07.2013 me vlerë 19,144,800 lekë dhe nr. 80761831 datë 24.07.2013 me vlerë 36,865,920 lekë. Hyrja në magazinë është bërë me FH nr. 10, datë 07.08.2013. Për mosrespektim të afatit të dorëzimit të mallrave janë llogaritur penalitete në shumën 491,546 lekë, vlerë e cila i është mbajtur furnizuesit "Infosoft System" shpk.

Nga auditimi u arrijmë në konkluzion se procedurat për tenderat e zhvilluara, janë në përputhje aktet ligjore në fushën e prokurimit publik.

Me procedurë "Blerje me vlera të vogla", sipas urdhër prokurimit nr. 22 datë 25.09.2012 është urdhëruar blerja e një Automjeti. Për blerjen e automjetit me shkresë të Ministrisë së Financave nr. 6760, datë 27.04.2012, është miratuar rialokimi i fondeve për blerje automjeti. Në zbatim të urdhër prokurimit Komisioni i blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga Teuta Kukaj Kryetare dhe Xhovana Xymerti e Ledio Braho anëtarë, ngritur me urdhër të brendshëm nr. 1, datë 03.01.2012, me datë 01.10.2012 ka mbajtur procesverbalin format 3, mbi testimin e tregut dhe me procesverbal format 4 mbajtur me datë 01.10.2012 ka shpallur ofertën fituese të depozituar nga firma "Auto Dupi" shpk, me vlerë 475,000 lekë me tvsh. Titullari i autoritetit kontraktor me urdhër të brendshëm nr. 21 datë 08.10.2012, ka ngritur grupin e kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim të automjetit i përbërë nga Admir Malaj Kryetar, Martin Prenoj dhe Saimir Neza anëtar. Komisioni i ngritur me urdhërin e sipërcituar me aktmarrje në dorëzim nr. 219, datë 09.10.2012, ka marrë në dorëzim automjetin ku përshkruan të dhënat mbi markën, tipin, vitin e prodhimit, nr e shasisë, ngrën, kilometrazhin, llojin e karburantit, dokumentacionin që e shoqëron, pa u shprehur mbi kolaudimin dhe gjendjen teknike të tij, veprim që e ngarkon me përgjegjësi komisionin.

Në të njëjtën datë që është ngritur komisioni i kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të automjetit titullari i autoritetit kontraktor ka nxjerrë Urdhër-Prokurimin nr. 25, datë 08.10.2012, për "Servis automjeti", sipas kontrollit teknik të kryer nga "Servis Iliri" shpk Tiranë. Bazuar në preventivin paraprak të hartuar nga "Servis Iliri" shpk, që ka përcaktuar nevojat për servis, komisioni i blerjeve me vlera të vogla me procesverbal format 3 dhe 4 ka testuar tregun dhe ka përzgjedhur fitues shoqërinë "Edilizja Dosseti" shpk me vlerë 479,940 lekë. Nga sa sipër auditit arrin në konkluzion se procedura "Blerje me vlera të vogla", përzgjedhur nga autoriteti kontraktor, ka sjellë blerjen e një automjeti në gjendje teknike jo të mirë dhe menjëherë pas blerjes ka lindur nevoja për servis.

Grupi i auditimit, falenderon me këtë rast, subjektin e audituar për bashkëpunimin e treguar në realizimin e këtij auditimi.

Raporti hartohet në dy kopje, një prej të cilave i paraqitet subjektit të audituar.
Bazuar në 11, gërma b dhe c, të Ligjit 9720 datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, Inspektoriati Qendror, brenda 30 ditësh, duhet të kthejë përgjigje për masat e marra në zbatim të Planit të Veprimit.

Për grupin e auditimit

Bajram KURTI



MEMORANDUM

Objekti i auditimit: *Auditim i Sistemit , Pajtueshmërisë dhe Financiar.*

Njësia e audituar: *Inspektoriati Qendror.*

Njësia audituese: *Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e MF-së*

I. Hyrje

Në këtë Raport janë paraqitur gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të auditimit të kryer pas përfundimit të misionit auditues të kryer në Inspektoriatin Qendror. Fushat e auditimit sipas parashikimit në Planin e auditimit janë; vlerësimi i sistemit të Kontrollit të Brendshëm; veprimtarisë së Inspektoriatit Qendror dhe menaxhimit financiar.

Auditimi u përqëndrua në zbatimin e ligjëshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit ekonomik e financiar të periudhës 01.01.2012 deri 30.04.2014.

Inspektoriati Qendror, është institucion i pavaruar dhe nuk ka njësi auditimi në strukturën e tij. Bazuar në ligjin nr. 9720 datë 23.04.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, ky institucion ka nënshkruar Akt-Marrëveshje nr. 6269/1, datë 28.04.2014, me Ministrinë e Financave për mbulimin me auditim nga njësia audituese e kësaj të fundit.

II. Termat e Auditimit

Auditimi, u krye në zbatim të Planit të Auditimit, nr. 7087/1, datë 13.05.2014. Periudha e audituar është 01.01.2012 deri 30.04.2014. Ky auditim u krye gjatë periudhës 19 Maj – 13 Qershor 2014, nga auditimi Bajram Kurti. Me shkesë nr. 7087/2, datë 06.06.2014, është zgjedhur afati deri më 13.06.2014.

Në zbatim të Manualit të AB, është njoftuar zyrtarisht subjekti nën auditim për fillimin e këtij misioni me shkresën nr. 7087, datë 09.05.2014. Nga grupi i auditimit u zhvillua takimi i fillimit me Drejtuesit e Inspektoriatit Qendror, ku u paraqitën objektivat e auditimit dhe palët ranë dakort për fillimin e punës. Në takim mori pjesë dhe Drejtuesja e Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

U zhvillua takimi përmblyllës me përfaqësuesit e Inspektoriatit Qendror, ku u diskutuan çështjet e rezultuara gjatë auditimit, si dhe rekomandimet. Raporti paraprak, i është dërguar subjektit të audituar me shkresën nr. 7087/3 datë 27.06.2014. Për raportin paraprak të auditimit, nga subjekti i audituar janë bërë vërejtje të cilat janë depozituar me shkresën nr.7087/4, datë 11.07.2014 dhe me e-mail datë 27.06.2014. Reagimi i auditit ndaj observacioneve është shprehur në çdo pikë të raportit që është observuar.

III. Metodatat e Përdorura

Grupi i auditimit ka përdorur metoda dhe teknika auditimi në vartësi të fushës së audituar. Është përdorur metoda e analizës së komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, auditimi një për një të trasaksioneve me bankë. Janë përdorur dhe teknikat e auditimit si: sondazhe, auditimi i rasteve me zgjedhje për përlllogaritjen e pagave, kontributeve, të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi dhe kahasimin me pagesën e punonjësëve, si dhe derdhja e tatimit dhe kontributeve në favor të organeve tatimore.

IV. Gjetjet e Auditimit

Pas përfundimit të punës në terren dhe pas diskutimit me subjektin e audituar, grupi i punës paraqet gjetjet e auditimit, konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse, sipas pikave të programit, sa më poshtë:

Veprimtaria e Inspektoriatit Qendrorë është e organizuar dhe funksionon bazuar në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në VKM nr. 630 datë 14.09.2011 “Për organizimin dhe Funksionimin e Inspektoriatit Qendror”, VKM nr 696 datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoriatit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi””, në rregulloren e brendëshme të Inspektoriatit Qendror, e ndryshuar, si dhe në akte e rregulla të brendëshme të institucionit. Në rregulloren e brendëshme, janë përcaktuar rregullat e funksionimit të Institucionit, detyrat dhe përgjegjësitë për drejtoritë, sektorët dhe të gjithë specialistët e këtij institucioni.

Në nene të veçanta të rregullores janë përcaktuar rregulla mbi mënyrën dhe format e komunikimit, rregullat e bashkëpunimit, raportimit, Etikës për punonjësit e Inspektoriatit Qendror dhe rregulla të tjera që lidhen me marrëdhëniet e punës.

Inspektoriatit Qendror, ka funksionuar dhe është organizuar mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar me urdhër të Kryeministrit.

Referuar ligjit “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nga Inspektoriati Qendror nuk është përgatitur një manual i përgjithshëm mbi procedurat e punës për dokumentimin dhe raportimin e veprimtarisë së inspektoriateve.

Për vitin 2012 dhe 2013, institucioni nuk ka bërë identifikimin e risqeve që mund të bëhen pengesë në realizimin e objektivave, si dhe nuk ka hartuar regjistrin e riskut.

Inspektoriati Qendror ka për mision përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë. Në bazë të strukturës së miratuar ekziston ndarja e detyrave sipas përshkrimeve të punës.

Për arritjen e objektivave të bashkëpunimit dhe mbështetjes së veprimtarisë së inspektoriateve shtetërore nga Inspektoriati Qendror, është ngritur dhe funksionon portali unik i Inspektimit që administrohet dhe mirëmbahet nga Inspektoriati Qendror.

Sistemi i kontrollit të brendshëm është vlerësuar me risk të ulët

Procedurat për ushtrimin e kompetencave dhe rregullat për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik të inspektimit janë miratuar me VKM, dy vjet pas miratimit të ligjit.

Nga auditimi u kostatua se nga Inspektoriati Qendror, në zbatim të kërkesave të VKM, nuk është dhënë mendim, Inspektoriateve shtetërore në hartimin e programeve vjetore të inspektimit për vitin 2014.

Nga Inspektoriati Qendror nuk është hartuar raporti vjetor i përgjithshëm i inspektimeve për vitin 2012. Raporti vjetor i përgjithshëm i inspektimeve për vitin 2013, nuk është i plotë. Disa inspektoriate nuk kanë paraqitur në Inspektoriatin Qendror raportet e tyre vjetore të inspektimeve duke mosrespektuar këtë detyrim ligjor.

Në zbatim të ligjit, Inspektoriati Qendror nuk ka rregulla të shkruara për procedurat e planifikimit dhe të kryerjes së kontrolleve për mbikëqyrjen e inspektimeve në inspektoriatet shtetërore.

Për periudhën objekt auditimi inspektoriati nuk ka programe vjetore të miratuara për mbikëqyrjen inspektimeve në inspektoriate. Për vitin 2012 janë realizuar 2 misione inspektimi, dhe për vitin 2013 është realizuar vetëm një mision inspektimi.

Në Inspektoriatin Qendror, mbajtja e kontabilitetit për periudhën objekt auditimi, është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Veprimet kontabile janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ku çdo regjistrim është bërë në bazë të dokumentave justifikuese dhe janë zbatuar drejt parimet e përgjithëshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Buxheti për paga e kontribute në vitin 2012 është përdorur në masën 92% dhe në vitin 2013 në masën 89%. Realizimi i buxhetit në kë zë për këtë vit është në nivel të kënaqshëm.

Nga auditimi mbi përdorimin e fondeve për paga, shpërblime dhe të tjera personeli si dhe sigurime Shoqërore e shëndetësore rezultoi se janë zbatuar kërkesat e akteve ligjore e nënligjore në këtë fushë.

Në një rast, detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat të muajit Janar 2014, janë derdhur në favor të tatimeve me vonesë me datë 20.03.2014. Në bazë të ligjit ky fenomen shoqërohet me efekte financiare, gjoba dhe penalitete për derdhje me vonesë.

Buxheti për shpenzime operative në vitin 2012 është përdorur në masën 82% dhe në vitin 2013 në masën 80%.

Buxheti i parashikuar për shpenzime operative në vitin 2014, nuk është i bazuar në nevojat reale, por, është parashikuar me rezerva. Ai është 5.39 herë më i lartë se buxheti i realizuar në vitin 2013.

Nga auditimi i plotë i veprimeve me bankë rezultoi se ata janë kryer në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

Në një rast në muajin Prill 2014, nuk rakordon shuma e pagesave me ekstratin e degës së thesarit për 16,954 lekë, pagesat sipas bankës më shumë se Thesari.

Nga auditimi i veprimeve në magazinë rezultoi se, dokumentacioni i hyrjeve dhe daljeve të mallrave dhe materialeve është plotësuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nga auditimi i shpenzimeve të karburantit u konstatua se nuk është mbajtur bilanci i konsumit të karburantit ku të evidentohen gjendja e karburantit në fillim të çdo periudhe (muaji,viti), furnizimi për periudhën sipas magazinës, konsumi sipas km të përshkuara me normativën për 100 km dhe gjendja në fund të periudhës.

Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore nga institucioni është kryer inventari i aktiveve.

Buxheti i parashikuar për shpenzime kapitale në vitin 2012 është përdorur në masën 91%, dhe për vitin 2013, është përdorur në masën 88%.

Nga auditimi i u konstatua se për periudhën e audituar vlera e kontratave të lidhura është në masën 90% e fondit limit të prokuruar.

Në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, pika 3, germa “b”, për vitin 2012, institucioni nuk ka dërguar në Agjensinë e Prokurimit Publik, regjistrin e parashikimeve dhe të realizimit të prokurimeve publike.

Në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, pika 3, germa “b”, paragrafi dytë regjistri i Parashikimit të prokurimeve publike dhe realizimit të shpenzimeve korente, për vitin 2014, nuk është dërguar në Agjensinë e Prokurimit Publik brenda datës 15 shkurt, por është dërguar me shumë vonesë, me datë 09.05.2014.

Në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, pika 3, germa “d” “Raportimi i realizimeve të prokurimit publik”, brenda datës 10 Maj, 10 Shtator dhe 10 Janar të çdo viti, nuk është hartuar dhe dorëzuar në organin qendror që ka vënë në dispozicion fondet një informacion i hollësishëm për veprimtaritë e realizuara të prokurimit.

Nga auditimi i ushtruar mbi zbatimin e procedurave të prokurimit për tenderat e zhvilluar në Inspektoriatin Qendror për vitin 2012 dhe 2013 rezultoi se janë mbajtur rregullisht dhe në afatin

kohor procesverbalet e mbledhjeve të komisionit të vlerësimit të ofertave, njoftimet e firmave pjesëmarrëse në tender si dhe relacionet për titullarin e autoritetit kontraktor.

Nga auditimi u konstatua se procedurat e ndjekura për tenderat e zhvilluara gjatë vitit 2012 dhe 2013, janë në përputhje aktet ligjore në fushën e prokurimit publik.

Nga auditimi u konstatua se procedura “Blerje me vlera të vogla”, e përzgjedhur nga autoriteti kontraktor, për blerje automjeti, ka sjellë blerjen e një automjeti në gjendje teknike jo të mirë dhe menjëherë pas blerjes ka lindur nevoja për servis.

Grupi i auditimit në përfundim të misionit ka lënë rekomandime për gjetjet sipas Plan Veprimit.

Për grupin e auditimit

Bajram KURTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 18022/2..... Prot.

Tiranë, më 23.1.2015

Drejtuar: Z. ILIR ZELA ✓

Inspektor i Përgjithshëm

Inspektorati Qëndror

Adresa: Rruga "Frosina Plaku", godina e Observatorit, Kati 0, Tiranë

Subjekti: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit

Në mbështetje të ligjit nr. 9720 datë 23.04.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, Aktmarveshjen e përbashket nr. 6269/1 datë 28.04.2014 midis Ministrisë së Financave dhe Inspektoratit Qëndror dhe Planin e Auditimit nr. 18022/1 datë 09.01.2015 "Për auditimin e zbatimit të rekomandimeve", ka përfunduar cikli auditues si dhe është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit në Inspektoratin Qëndror.

Në cilësinë e titullarit të institucionit, përfundimet e auditimit duhet të adresohen nga Inspektori i Përgjithshëm për strukturat në vartësi të tij dhe një kopje duhet ti vihet në dispozicion Drejtorisë së auditimit në MF.

Për sa më sipër bashkëlidhur, Raporti i auditimit dhe formati i përfundimeve të auditimit.

TATJANA ELEZI

DREJTOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI QËNDRORË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2015

Drejtuar: Zj. Teuta KUKAJ
Drejtores
Drejtoria e Mbikqyrjes dhe Inspektimit
Inspektorati Qëndror

Z. Martin PRENOJ
Drejtor
Drejtoria e Udhëheqjes Metodologjike dhe Koordinimit
Inspektorati Qëndror

Zj. Aida FEJZO
Specialiste Finance
Inspektorati Qëndror

Subjekti: Përfundimet e auditimit

Bazuar në ligjin nr. 9720 datë 23.04.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, Aktmarveshjen e përbashkët nr. 6269/1 datë 28.04.2014 midis Ministrisë së Financave dhe Inspektoratit Qëndror, si dhe sipas Planit të Auditimit nr.18022/1 datë 09.01.2015, ka përfunduar procesi i auditimit për zbatimin e rekomandimeve në Inspektoratin Qëndror.

Grupi i auditimit gjatë realizimit të këtyre angazhimeve ka raportuar se, Inspektorati Qëndror i ka realizuar të 7 rekomandimet e lëna.

Bazuar në gjetjet e konstatuara, të trajtuara gjerësisht gjatë procesit të auditimit, të evidentuara në raportin paraprak dhe në raportin final të angazhimit të auditimit, për përmirësimin e punës në të ardhmen, në bazë të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, si dhe Aktmarveshjen e përbashkët nr. 6269/1 datë 28.04.2014, pas vlerësimit të Raportit të auditimit:

URDHËROJ:

1. Përfundimin e misionit të auditimit të kryer në Inspektoratin Qëndror, në fushën e zbatimit të rekomandimeve.

Bashkëlidhur urdhrit, raporti i auditimit.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ILIR ZELA


INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm

Objekti I auditimit: Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2014

Njësia e audituar: Inspektorati Qëndror

Njësia Audituese : Drejtoria e Auditimit të Brendshëm

I. Hyrje

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e Ministrisë së Financave, ka përfunduar auditimin në Inspektoratin Qëndror "Për auditimin e zbatimit të rekomandimeve". Zbatimi i rekomandimeve i referohet auditimit të fundit të kryer gjatë vitit 2014, "Për vlerësimin e sistemeve, pajtueshmërisë dhe menaxhimin financiar". Auditimi u fokusua në realizimin e Planit të veprimit të hartuar për zbatimin e rekomandimeve.

Përgatitja e raportit paraprak është bërë njëherësh dhe raport përfundimtar, pasi Inspektorati Qëndror i ka realizuar rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm.

II. Termat e Auditimit

Auditimi u krye gjatë periudhës 12 Janar 2015, nga audituesja Rexhina Mikeli, në zbatim të planit të auditimit Nr.18022/1 datë 09.01.2015. Bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, është njoftuar zyrtarisht subjekti nën auditim, për fillimin e këtij misioni. U zhvillua takimi i fillimit me Inspektorin e Përgjithshëm, ku u prezantua tematika e auditimit dhe u ra dakort për fillimin e punës. Më poshtë po paraqesim Raportin Përfundimtar.

III. Metodat e Përdorura

Për realizimin e misionit u auditua zbatimi i 7 rekomandimeve të lëna. U verifikua një për një realizimi i secilit rekomandim.

IV. Gjetjet e Auditimit

Në zbatim të planit të auditimit rezultoi si më poshtë:

1.Zbatimi i nenit 11/b të ligjit nr.9720 date 23.04.2007, për hartimin dhe zbatimin e planit të masave për realizimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm 2014. Respektimi i afatit 30 ditor për njoftimin e tyre në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm.

U auditua zbatimi i procedurave për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve dhe njoftimin e tyre në DAB- dhe u konstatua se:

Me shkresën nr. 5681/6 datë 15.07.2014 të Ministrisë së Financave, i janë përcjellë Inspektoratit Qëndror përfundimet e auditimit dhe raporti përfundimtar me rekomandimet përkatëse. Inspektori i Përgjithshëm, me shkresën nr.191 datë 18.07.2014, ka nxjerrë urdhërin

“Rekomandimet e auditimit për zbatim” drejtuar njësive vartëse të tij. Me shkresën nr.6269/3 datë 26.08.2014 (protokolluar me tonën), ky institucion ka njoftuar Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm “Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dhëna”, në përputhje me nenin 11 pika b, të ligjit të auditimit.

2. Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna dhe i dokumentimit të procesit për çdo rekomandim.

Statusi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna paraqitet;

Rekomandim 1 - Inspektorati Qëndror, të hartojë dhe miratojë manualin e përgjithshëm mbi procedurat e dokumentimit dhe raportimit të veprimtarisë së inspektoriateve.

Rekomandimi është realizuar.

Nga verifikimi rezultoi se është hartuar draft/manuali i përgjithshëm i inspektimit, draft të cilin Drejtoria e Udhëheqjes Metodologjike dhe e Koordinimit e ngarkuar për hartimin e saj, ua ka kaluar për mendim (me email) stafit të institucionit. (kopje e emailit dhe e draftit në dosje)

Rekomandimi 2 – Për arritjen e objektivave, Inspektorati Qëndror të evidentojë, vlerësojë risqet dhe hartojë regjistrin e riskut”.

Rekomandimi është realizuar.

Me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm nr.30 datë 25.04.2014, është ngarkuar Drejtoria e Udhëheqjes Metodologjike për hartimin e regjistrin të rriskut, e cila ka hartuar dhe miratuar regjistrin e riskut për veprimtarinë e këtij institucioni me nr. Prot. 30/1 datë 30.09.2014. (kopja në dosje)

Rekomandimi nr. 3- Inspektorati Qëndror, menjëherë të hartojë dhe të miratojë metodologjinë mbi procedurat e planifikimit dhe kryerjes së kontrolleve për mbikëqyrjen e inspektimeve në inspektoriatet shtetërore.

Rekomandimi është realizuar

Me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 74 datë 30.12.2014, është miratuar « Manuali i Mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese pranë inspektoriateve shtetërore/ vendore dhe trupave të tjera inspektuese ». (kopje urdhërit dhe manualit në dosje)

Rekomandimi nr. 4- Inspektorati Qëndrorë, të rakordojë me DRT Tiranë dhe në rast penalizimi, të analizojë përgjegjësitë e dëmit të shkaktuar nga mospagesa në afat e detyrimeve.

Rekomandimi është realizuar nga Inspektorati.

Nga verifikimi rezultoi se në lidhje me rekomandimin e mësipërm, Inspektori i Përgjithshëm i është drejtuar zyrtarisht Drejtorisë RajonaleTatimore Tiranë me shkresën nr. 207 dt.15.08.2014, në të cilën ju është sqaruar tatimeve arsyeja për pagesën me vonesë të kontributeve (institucioni ka qenë pa titullar gjatë asaj periudhe). Nga D.R.Tatimore Tiranë, nuk është marrë përgjigje dhe as nuk është aplikuar asnjë sanksion për pagesën me vonesë të kontributeve, si e tillë rekomandimi konsiderohet i realizuar. (kopje e shkresës në dosje)

Rekomandimi nr. 5- Inspektorati Qëndror, të analizojë nevojat për buxhet në zërin shpenzime operative për periudhën deri në fund të vitit dhe në rast se fondet rezultojnë më të larta se nevojat të kërkojë rishpërndarje të buxhetit.

Rekomandimi është realizuar.

Me shkresën nr. 322 datë 15.12.2014, Inspektorati Qëndror i ka dërguar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në MF, në lidhje me fondet e lira të parashikuara për tu mos përdorur deri në fund të vitit 2014, nga zërat 602 “shpenzime operative” në vlerë 13,500 mijë lekë dhe zëri 231 “Investime” në vlerën 4,183 mijë lekë. (dokumentat në dosje)

Rekomandimi nr. 6- Të rakordohen urdhër-shpenzimet e muajit Prill 2014 me degën e thesarit dhe të sistemohet diferenca për 16,954 lekë.

Rekomandimi është realizuar.

Për realizimin e këtij rekomandimi rezultoi se, janë kryer sistemimet përkatëse dhe janë mbajtur akt rakordime me degën e thesarit Tiranë dhe nuk kanë rezultuar diferenca. (kopje të akt-rakordimeve në dosje)

Rekomandimi nr.7- Menjëherë titullari i institucionit të miratojë rregulla mbi mënyrën e dokumentimit dhe kontrollit të harxhimit të karburantit.

Rekomandimi është realizuar.

Me urdhërin nr. 56 datë 14.08.2014, të inspektorit të përgjithshëm, është ngritur komisioni për përcaktimin e normës së harxhimit të karburantit. Më datë 18.08.2014 është mbajtur procesverbali i përcaktimit të normës së harxhimit të karburantit për autoveturën e institucionit. Është miratuar dhe rregullore e përdorimit të automjetit të institucionit nr. 9/1 datë 21.08.2014.

3. Konkluzione mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga njësia e audituar.

Grupi i auditimit arrin në konkluzionin se:

Inspektorati Qëndror i ka realizuar të 7 rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm. Niveli i realizimit të rekomandimeve është në masën 100%.

Grupi i auditimit falenderon Drejtuesin e institucionit dhe stafin, për bashkëpunim në përmbushjen e misionit të auditimit.

Bazuar në Ligjin nr. 9720 datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 21 pika 7, dhe në Manualin e AB e akte të tjera në zbatim të tij, hartohet ky raport përfundimtar i auditimit, pasi nuk është e nevojshme hartimi i raportit paraprak dhe i përcillet subjektit të audituar.

Grupi i auditimit


Rexhina Mifteli